LIGJ
Nr. 39/2026

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE *CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A.*, "PËRMIRËSIMI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË VERI TË SHQIPËRISË PAS TËRMETIT TË VITIT 2019"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*, "Përmirësimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në veri të Shqipërisë pas tërmetit të vitit 2019", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 286, datë 5.5.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

F.ROT/AID 21/003/00

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE *CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.p.A.*
35,000,000.00 EURO "PËRMIRËSIMI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË VERI TË SHQIPËRISË PAS TËRMETIT TË VITIT 2019

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si **"Huamarrësi")**,

nga njëra anë,

dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*, me kapital aksionar prej 4,051,143,264.00 eurosh, me seli të regjistruar në Romë, Via Goito 4, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me nr. 80199230584, me numër tatimor dhe TVSH nr. 07756511007 (në vijim referuar si **"CDP"**), në cilësinë e administratorit, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Italiane, të Fondit Xhirues për Bashkëpunim dhe Zhvillim themeluar nga Qeveria e Italisë në bazë të nenit 26 të ligjit italian nr. 227, datë 24 maj 1977, dhe më tej referuar nenit 8 të ligjit italian nr. 125, datë 11 gusht 2014, i ndryshuar herë pas here, përfaqësuar nga z. Paolo Lombardo – Drejtori për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, nga ana tjetër.

(CDP-ja dhe Huamarrësi, së bashku në vijim referuar si "**Palët**")

Duke pasur parasysh se:

A. Në përputhje me Marrëveshjen e njohur si "Marrëveshja" (në vijim referuar si **"Marrëveshja"**), të nënshkruar në Tiranë më 27 mars 2023 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, kjo e fundit ka marrë përsipër ta financojë Programin (siç përkufizohet më poshtë), nëpërmjet një huaje të butë deri në shumën maksimale prej 35,000,000.00 (tridhjetë e pesë milionë eurosh);

B. Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Qeverisë së Republikës Italiane, me dekretin nr. 43324, datë 20 maj 2021 (në vijim referuar si **"Dekreti"**), autorizoi CDP-në për t'i akorduar Huamarrësit një hua të butë, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje Financiare (siç përkufizohet më poshtë), për qëllimin e financimit të Programit;

C. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje Financiare, Palët synojnë të përcaktojnë dispozitat kontraktuale dhe kushtet financiare, që lidhen me huan e butë, siç parashikohet në nenin 9 të Marrëveshjes dhe dekretit;

Në funksion të kësaj, kanë vendosur ta lidhin këtë **Marrëveshje Financiare.**

Neni 1
Përkufizimet dhe Interpretimi

1.1 Pikat dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje Financiare janë pjesë integrale dhe thelbësore e saj.

1.2 Në këtë Marrëveshje Financiare dhe në shtojcat e saj, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:

- **"Llogari"** nënkupton llogarinë e veçantë të hapur nga Huamarrësi pranë Bankës së Shqipërisë, ku CDP-ja do të kreditojë disbursimet e Huas së Butë, në favor të Huamarrësit, të cilat më pas do të transferohen në një llogari operative të hapur në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri;
- **"Deklaratë e Pranimit të Detyrimit Financiar"** nënkupton deklaratën e përmendur në nenin 8, me anë të së cilës Huamarrësi pranon që është debitor i CDP-së dhe angazhohet, në funksion të CDP-së, ta shlyejë kapitalin bashkë me interesat e akumuluar dhe çdo shumë tjetër të detyrueshme, në lidhje me Huan e Butë, sipas planit përkatës të shlyerjes së shumës së disbursuar, që duhet të përgatitet në përputhje me shtojcën B (Formulari i Deklaratës së Pranimit të Detyrimit Financiar) të kësaj Marrëveshjeje Financiare;
- **"AICS"** nënkupton Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim;
- **"Rregullat kundër Pastrimit të Parave"** nënkupton dekretin legjislativ nr. 231/2007 dhe ndryshimet pasuese të tij (i ashtuquajturi "dekret kundër pastrimit të parave") dhe dispozitat zbatuese të miratuara nga Banka e Italisë në përputhje me nenin 7, pika 1, të të njëjtit dekret mbi njohjen e klientit (i ashtuquajturi "njih klientin tënd");
- **"Raporte Financiare të Audituara"** nënkupton raportet financiare dhe teknike të lëshuara nga Shoqëria e Auditimit;
- **"Shoqëri Auditimi"** nënkupton një shoqëri auditimi me kualifikim të lartë, të njohur ndërkombëtarisht, zgjedhur nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, të miratuar nga AICS-ja dhe e ngarkuar me detyrën e auditimit të dokumenteve dhe procedurave financiare dhe administrative në lidhje me Programin, siç përcaktohet në nenin 4;
- **"Periudhë Disponueshmërie"** nënkupton periudhën gjatë së cilës mund të kryhen disbursimet, duke filluar nga data e disbursimit të parë deri (dhe përfshirë) datën pas 48 (dyzet e tetë) muajsh;
- **"Përfitues"** nënkupton konkretisht "Përfituesin" e parashikuar sipas dekretit legjislativ nr. 231/2007;
- **"Model CDP 231"** nënkupton modelin e menaxhimit dhe kontrollin organizativ të miratuar nga CDP-ja, sipas dekretit legjislativ italian 231, i disponueshëm në faqen e internetit të CDP-së (www.cdp.it);

- **"Llogari CDP-je"** nënkupton llogarinë e CDP-së me të dhënat e IBAN-it IT06Z0760203200000000000122 – Bic/Swift CADPITRRXXX, ku Huamarrësi do të keditojë shlyerjen e Huas së Butë në funksion të CDP-së;

- **"Kod Etik i CDP-së"** nënkupton kodin etik të miratuar nga CDP-ja, i disponueshëm në faqen e internetit (www.cdp.it);

- **"Politika kundër korrupsionit e grupit CDP"** nënkupton politikën e publikuar në faqen zyrtare të CDP-së (www.cdp.it), që lidhet me parimet dhe masat e ndërmarra nga CDP-ja dhe shoqëritë që i nënshtrohen drejtimit dhe koordinimit nga CDP-ja, sipas nenit 2497 e në vijim të Kodit Civil Italian;

- **"Marrëveshje Financiare"** nënkupton këtë marrëveshje financiare, së bashku me pikat dhe shtojcat që përbëjnë pjesën integrale të saj;

- **"Moratorium"** nënkupton periudhën që fillon nga data e disbursimit të parë dhe përfundon pas 144 (njëqind e dyzet e katër) muajsh;

- **"Autoritete Kompetente Italiane"** nënkupton MEF-in (Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave) dhe/ose Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Italiane dhe/ose AICS-it dhe/ose çdo subjekt tjetër kompetent të Qeverisë Italiane të emëruar për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje Financiare;

- **"MAECI-DGCS"** nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Italiane – Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim;

- **"MEF"** nënkupton Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të Republikës Italiane;

- **"Agjenci Ekzekutive"** nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë (MIE), si Agjencia kryesore Zbatuese;

- **"Agjenci Zbatuese"** nënkupton "OSHEE Group sh.a.", konkretisht Operatori Shqiptar i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

- **"Program"** nënkupton Programin me titull "Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike në Veri të Shqipërisë pas tërmetit të vitit 2019", i cili do të financohet nëpërmjet Huas së Butë, sipas Marrëveshjes dhe kësaj Marrëveshjeje Financiare;

- **"Kërkesë për Disbursim"** nënkupton kërkesën e bërë nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese për disbursimin e Huas së Butë, kryesisht në formën e shtojcës A (Formulari i Kërkesës për Disbursim) dhe në përputhje me këtë Marrëveshje Financiare;

- **"Hua e Butë"** nënkupton mekanizmin financiar që CDP-ja ka ndërmarrë t'ia japë Huamarrësit mbi bazën e autorizimit të dhënë me dekret dhe në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Financiare;

- **"Kontratë/a furnizimi"** nënkupton kontratën/at tregtare që lidhet/n me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të lidhura me zbatimin e Programit.

Neni 2
Huaja e Butë

2.1 Në përputhje me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare, CDP-ja i akordon Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon Huan e Butë, si më poshtë:

- Shuma: 35,000,000.00 euro (tridhjetë e pesë milionë euro);

- Kohëzgjatja: 25 (njëzet e pesë) vjet;

- Moratoriumi: 144 (njëqind e dyzet e katër) muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë; shlyerja: 26 (njëzet e gjashtë) këste principali të barabarta të njëpasnjëshme 6-mujore, ku kësti i parë bie 150 (njëqind e pesëdhjetë) muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë;

- Norma e interesit: 0.5% (zero pikë pesë për qind) në vit;

- Qëllimi i kredisë: "Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike në Veri të Shqipërisë pas tërmetit të vitit 2019";

- Kanalizimi i Huas drejt Agjencisë Zbatuese të Projektit;

- Marrëveshje Kanalizimi: Huamarrësi do ta kanalizojë Huan drejt Agjencisë Ekzekutive të Projektit, sipas një marrëveshjeje të veçantë nënhuaje me të njëjtët terma dhe kushte me këtë Marrëveshje Financiare.

2.2 Huaja e Butë do të përdoret për Programin. Shuma totale që lidhet me Huan e Butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe importet e mallrave dhe shërbimeve që e kanë origjinën nga vende të tjera.

Kontratat e furnizimit duhet të jenë të shprehura/të konvertuara në euro. Disbursimet do të kryhen vetëm në euro.

2.3 Huaja e Butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksa vendore, tarifa doganore, TVSH.

2.4 Huaja e Butë do të vihet në dispozicion në tri disbursime, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 6, mbi llogarinë.

2.5 Interesat e llogaritur mbi bilancin e llogarive ku do të përfshihen fondet e disbursuara, do të regjistrohen në pasqyrat financiare të Projektit dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim dhe me të njëjtat modalitete si Huaja e Butë.

Neni 3

Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financiare

3.1 Kjo Marrëveshje Financiare hyn në fuqi pasi CDP-ja të ketë marrë provat e pranueshme të dokumenteve të mëposhtme nga Huamarrësi:

i. Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që vërteton kompetencat dhe autoritetin e Huamarrësit për ta nënshkruar këtë Marrëveshje Financiare një person i autorizuar, sipas rregullave në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe efikasitet të plotë në Shqipëri, në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, dhe për të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Financiare.

ii. Emërimin me shkrim nga Huamarrësi (dërguar nëpërmjet Ambasadës Italiane në Republikën e Shqipërisë) të personave të autorizuar, sipas rregullave për ta nënshkruar këtë Kërkesë Disbursimi, në kuadër të Marrëveshjes Financiare në formën e shtojcës A dhe Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar në formën e shtojcës B, të përmendur në nenet 6 dhe 8 më poshtë. Një përcaktim i tillë duhet të specifikojë emrin dhe detyrën e këtyre personave dhe të përmbajë "formularin ekzemplar" të përditësuar të nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim i saj (nëse ka), duhet të transmetohet në kohën e duhur nga Huamarrësi te CDP-ja;

iii. Një deklaratë dhënë CDP-së nga Agjencia Zbatuese që vërteton hapjen e llogarisë dhe detajet e saj të dërguara, gjithashtu, në kopje/për dijeni Bankës, ku është hapur llogaria.

3.2 CDP-ja, pas marrjes së dokumenteve të lartpërmendura në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, do të njoftojë Huamarrësin dhe AICS-in, me anë të një shkrese, e cila do të konfirmohet më pas me shkresë, për datën kur ka hyrë në fuqi kjo Marrëveshje Financiare.

3.3 Nëse të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 3.1 nuk plotësohen ose nuk përjashtohen nga CDP-ja dhe/ose Huamarrësi nuk e ka dorëzuar Kërkesën e parë për Disbursim brenda 12 muajve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Financiare, në bazë të udhëzimeve të Autoriteteve Kompetente Italiane, të cilat do të veprojnë sipas diskrecionit të tyre, me njoftim drejtuar Huamarrësit, CDP-ja mund:

1. Ta deklarojë të anuluar shumën e patërhequr të Huas së Butë; dhe
2. Ta ndërpresë këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 4

Shoqëria e Auditimit

4.1 Në përputhje me nenin 11 të Marrëveshjes, Agjencia Zbatuese do t'i besojë një Shoqërie Auditimi detyrën për të kryer auditimin e operacioneve që lidhen me Huan e Butë, sipas përshkrimit në nenin 4.2 më poshtë.

4.2 Marrëveshja ndërmjet Agjencisë Zbatuese dhe Shoqërisë së Auditimit duhet të paraqitet për miratim pranë AICS-së përpara nënshkrimit të saj. AICS-ja duhet t'ia konfirmojë me shkrim CDP-së nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Agjencisë Zbatuese dhe Shoqërisë së Auditimit.

4.3 Shoqëria e Auditimit duhet të përcaktojë një format standard të Raportit Financiar të Audituar, i cili duhet të miratohet nga AICS, Agjencia Zbatuese dhe CDP-ja, bazuar në aktivitetet e rregulluara në Marrëveshje dhe në këtë Marrëveshje Financiare. Agjencia Zbatuese do t'ia dërgojë këtë format për miratim AICS-së dhe CDP-së.

4.4 Raportet Financiare të Audituara për Programin do të dërgohen nga Agjencia Zbatuese pranë CDP-së dhe AICS-it dhe do të: i. përfshijnë raportet financiare dhe teknike; dhe ii. do të vërtetojnë rregullsinë dhe përputhshmërinë me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare për çdo transaksion financiar që lidhet me Huan e Butë. Në rast shpenzimesh në monedhë vendëse, Shoqëria e Auditimit duhet ta reflektojë të aplikuar vlerën ekuivalente në euro dhe kursin përkatës të këmbimit euro/monedhë vendëse. Shoqëria e Auditimit duhet të përgatisë, gjithashtu, Raportet e Audituara të Prokurimit sipas nenit 11.2 (b) të Marrëveshjes.

4.5 Shoqëria e Auditimit duhet të përgatisë një Raport Përfundimtar Auditimi Financiar dhe Raport Prokurimesh, në përputhje me nenin 6.9, i cili duhet të miratohet nga AICS dhe CDP-ja (në vijim referuar si **"Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar dhe Raportit të Prokurimeve"**).

Neni 5
Periudha e Disbursimit të Huas së Butë

5.1 Huaja e Butë do të jetë e disponueshme për disbursim gjatë Periudhës së Disponueshmërisë. Kërkesa për Disbursim mund të paraqitet që nga data kur të jenë përmbushur ose të jenë hequr nga CDP-ja të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 3. Nëse është e nevojshme, Periudha e Disponueshmërisë mund të zgjatet nga CDP-ja, pas konsultimit me Autoritetet Kompetente Italiane, me kërkesë me shkrim të Huamarrësit dërguar CDP-së të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike përpara datës së skadimit dhe një kopje dërguar për dijeni MAECI-DGCS dhe AICS.

5.2 Nëse periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk është zgjatur sipas nenit 5.1 më lart, CDP-ja do t'ia komunikojë Huamarrësit anulimin e angazhimit të CDP-së për fondet e papërdorura, pas konsultimit me Autoritetet Kompetente Italiane.

Neni 6
Kushtet dhe modalitetet e disbursimit të Huas së Butë

6.1 Disbursimi nga CDP-ja do të jetë i kushtëzuar nga paraqitja paraprake tek CDP-ja e dokumenteve të nevojshme prej Huamarrësit për përfundimin, siç duhet të procedurave të brendshme të CDP-së mbi parandalimin e pastrimit të parave (njih klientin tënd).

6.2 Me kusht që kjo Marrëveshje Financiare të ketë hyrë në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, ka të drejtë të dorëzojë pranë CDP-së një Kërkesë për Disbursim të plotësuar sipas rregullave, në përputhje me dispozitat e parashikuara në të. Çdo Kërkesë për Disbursim duhet të shoqërohet me kopje të një pasaporte të vlefshme të personit të autorizuar sipas rregullave, i cili e ka nënshkruar Kërkesën për Disbursim.

6.3 Pa cenuar nenet 6.11, 6.12, 6.13 dhe 15, CDP–ja do të kryejë pagesën e kërkuar sipas çdo Kërkese për Disbursim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së Kërkesës përkatëse për Disbursim.

Kërkesa e parë për Disbursim e dorëzuar nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, në përputhje me shtojcën A do të jetë për shumën maksimale prej 10,000,000.00 (dhjetë milionë) eurosh.

6.4 Kërkesa e dytë për Disbursim e dorëzuar nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, në përputhje me shtojcën A) do të jetë për shumën maksimale prej 15,000,000.00 eurosh (pesëmbëdhjetë milionë) dhe do të kreditohet, pasi të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme në formë dhe përmbajtje të pranueshme për CDP-në:

- përmbushja e kushteve të përcaktuara në nenet 4.1, 4.2 dhe 4.3;
- verifikimi dhe miratimi nga zyra e AICS-it në Tiranë dhe CDP-ja të Raportit Financiar të Auditimit të marrë nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese. Ky Raport Financiar Auditimi duhet të mbulojë shpenzimet për të paktën 30% (tridhjetë për qind) të shumës së disbursimit të parë

dhe të dëshmojë se të paktën 50% (pesëdhjetë për qind) të të ardhurave nga disbursimi i parë janë aktivizuar. AICS-ja dhe CDP-ja do ta informojnë Huamarrësin, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, për rezultatet e verifikimit, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së Raportit Financiar të Auditimit. Në rast se Shoqëria e Auditimit, AICS-ja apo CDP-ja identifikojnë ndonjë parregullsi, CDP-ja, në marrëveshje me AICS-in, do ta pezullojë disbursimin e Huas së Butë. Vetëm pasi AICS-ja t'ia konfirmojë CDP-së se i ka marrë siç duhet detajet nga Shoqëria e Auditimit dhe Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, për zgjidhjen pozitive të këtyre parregullsive, CDP-ja do ta kryejë pagesën e shumave të kërkuara sipas Kërkesës përkatëse për Disbursim;

- miratimi nga zyra e AICS-it në Tiranë, i Raportit të Auditimit të Prokurimeve. Ky miratim duhet t'i komunikohet CDP-së nga AICS.

6.5 Nëse disa nga shpenzimet e përfshira në Raportin Financiar të Auditimit nuk miratohen nga AICS-ja dhe/ose CDP-ja, Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, angazhohet në mënyrë të parevokueshme të rikthejë në llogari shumat e barasvlershme me ato shpenzime, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga kërkesa e CDP-së.

6.6 Pas rastit të përshkruar në nenin 6.5 më sipër, disbursimi i dytë do të kryhet vetëm pasi llogaria të jetë rimbushur nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, me një shumë të barabartë me vlerën e shpenzimeve që nuk janë miratuar. Në mënyrë alternative, disbursimi i dytë do të kryhet me zbritjen e shumës që lidhet me shpenzimet e pamiratuara sipas disbursimit të parë.

6.7 Kërkesa e tretë për Disbursim e dorëzuar nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, në përputhje me shtojcën A), do të jetë për shumën maksimale prej 10,000,000.00 (dhjetë milionë) eurosh, dhe do të kreditohet nëse përmbushet kushti i mëposhtëm në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga CDP-në:

- verifikimi dhe miratimi nga zyra e AICS-së në Tiranë dhe CDP-ja i Raportit Financiar të Auditimit të marrë nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese. Ky Raport Financiar Auditimi duhet të vërtetojë se të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) e kostove kumulative të parashikuara për këstin e parë dhe të dytë, janë aktivizuar dhe 40% (dyzet për qind) janë disbursuar. AICS-ja dhe CDP-ja do ta informojnë Huamarrësin nëpërmjet Agjencisë Zbatuese për rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së Raportit Financiar të Auditimit. Në rast se Shoqëria e Auditimit, AICS-ja, apo CDP-ja, identifikojnë ndonjë parregullsi, CDP-ja, në marrëveshje me AICS-in, do ta pezullojë disbursimin e Huas së Butë. Vetëm pasi AICS-ja t'ia konfirmojë CDP-së se ka marrë të dhëna produktive nga Shoqëria e Auditimit dhe nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, për zgjidhjen pozitive të këtyre parregullsive, CDP-ja do ta ekzekutojë pagesën e shumave të kërkuara sipas Kërkesës përkatëse për Disbursim.

- miratimi nga zyra e AICS-së në Tiranë, i Raportit të Auditimit të Prokurimeve; ky miratim duhet t'i komunikohet CDP-së nga AICS.

6.8 Brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga disbursimi i fundit i Huas së Butë, Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese duhet të dorëzojë Raportin Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe Raportin e Prokurimeve. Ky Raport Përfundimtar i Auditimit Financiar dhe Raporti i Prokurimeve duhet të përfshijë të gjitha shpenzimet që lidhen me disbursimin total të Huas së Butë dhe duhet të miratohet nga AICS-së dhe CDP-ja brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së tij nga CDP-ja, pasi të zbatohet procedura e përshkruar në nenin 6.4.

6.9 Nëse ndonjë shumë disbursuar Huamarrësit nga CDP-ja, nuk miratohet nga AICS-ja dhe CDP-ja, ose nuk përdoret brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit të fundit të Huas së Butë, ajo shumë duhet t'i kthehet CDP-së nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas komunikimit nga CDP-ja tek Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese.

6.10 Pas çdo disbursimi të Huas së Butë në llogari, CDP-ja duhet t'i dorëzojë Huamarrësit me shkresë afatin e shlyerjes së shumave të disbursuara, duke treguar datat e maturimit të kësteve të shlyerjes. Çdo afat shlyerjeje, i përfunduar në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 7 më poshtë, duhet të pranohet me shkrim nga Huamarrësi. Nëse Huamarrësi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e shkresës përkatëse të CDP-së, nuk e pranon me shkrim afatin e shlyerjes, ky i fundit do të konsiderohet i pranuar në mënyrë të pakthyeshme nga Huamarrësi.

6.11 CDP-ja do t'i kryejë pagesat sipas Kërkesës për Disbursim vetëm në rast se shumat përkatëse janë vënë në dispozicion nga Autoritetet Kompetente Italiane.

6.12 CDP-ja nuk do të kryejë pagesa në kuadër të ndonjë Kërkese për Disbursim, kur kjo është ose bëhet e paligjshme, apo është në kundërshtim me ndonjë rregull apo rregullore të CDP-së, që të: i. përmbushë ndonjë nga detyrimet e saj. siç parashikohet në këtë Marrëveshje Financiare; ose të ii. sigurojë pjesëmarrjen e saj në Huan e Butë. Në një rast të tillë, CDP-ja, pas konsultimit me Autoritetet Kompetente Italiane, do ta informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të saj të papërmbushur në lidhje me Huan e Butë dhe Huamarrësi do të shlyejë paraprakisht të gjithë ose një pjesë të principalit dhe interesit të akumuluar mbi Huan e Butë, së bashku me çdo shumë tjetër të akumuluar ose të detyrueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe Marrëveshjes.

6.13 CDP-ja nuk mban përgjegjësi ndaj Huamarrësit, në rast se disbursimi i Huas së Butë nuk bëhet ose vonohet për arsye që nuk i takojnë CDP-së, duke përfshirë rastin e përshkruar në nenet 6.12 dhe 6.13.

6.14 Konfirmimet e mëposhtme duhet të përsëriten nga Huamarrësi në secilin prej disbursimeve të kërkuara nga Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese:

- Huamarrësi ndërmerr në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme të shlyejë shumën përkatëse në euro, të kredituar nga CDP-ja në llogari, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar në Marrëveshjen Financiare.
- Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e disbursimit të fundit të Huas së Butë të kërkuar si më poshtë, Huamarrësi vendos t'i japë CDP-së Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar për të gjitha shumat e disbursuara sipas Marrëveshjes së Huas.

Neni 7
Shlyerja e Huas së Butë dhe pagesa e interesit

7.1 Shuma totale e Huas së Butë e kredituar nga CDP-ja në llogari, do të shlyhet sipas afatit të pagesave në 26 (njëzet e gjashtë) këste gjashtëmujore të barabarta, të njëpasnjëshme (në vijim të referuara si **"Këste Principali"**), ku kësti i parë do të kërkohet pas 150 (njëqind e pesëdhjetë) muajsh nga data e disbursimit të parë. CDP-ja do t'i dërgojë Huamarrësit planin përkatës sipas nenit 6.11 më lart.

7.2 Me disbursimin e Huas së Butë, do të fillojë llogaritja e interesave, të cilat do të llogariten me normë vjetore nominale prej 0.5% (zero pikë pesë për qind) dhe do të paguhen në çdo datë maturimi. Interesat do të llogariten mbi numrin e ditëve reale të kaluara, duke përdorur metodën e një muaji prej tridhjetë ditësh dhe një viti prej treqind e gjashtëdhjetë ditësh (30/360).

7.3 Huamarrësi angazhohet të kryejë të gjitha shlyerjet e detyrimeve dhe pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, si edhe sipas Deklaratës së Pranimit të Detyrimit Financiar, në datat përkatëse të maturimit, për shumën përkatëse në euro, në funksion të CDP-së në llogarinë e CDP-së. Këto shuma duhet të kreditohen në fonde të disponueshme menjëherë, pa pengesa dhe pa asnjë zbritje apo ndalesë. CDP-ja mund t'i dërgojë Huamarrësit njoftim përpara datës së pagesës së maturimit. Nëse për çfarëdolloj arsyeje, Huamarrësi nuk e merr këtë njoftim, ai, gjithsesi, do të angazhohet t'i kryejë të gjitha pagesat dhe shlyerjet sipas afatit të pagesave, pa vonesë. Për çdo pagesë dhe shlyerje, Huamarrësi duhet t'i tregojë CDP-së numrin e Marrëveshjes Financiare dhe shumën totale të Huas së Butë dhe të detajojë për çdo datë maturimi shumat e paguara.

Neni 8
Dorëzimi i Deklaratës së Pranimit të Detyrimit Financiar

8.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e skadimit të disbursimit të fundit të Huas së Butë, e përcaktuar në nenin 5.1, Huamarrësi duhet t'i dorëzojë CDP-së Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar, e cila duhet të jetë nënshkruar dhe e sigluar sipas rregullave nga Huamarrësi në çdo faqe, sipas së cilës ai deklaron në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme se është debitor ndaj CDP-së.

8.2 Afati i shlyerjes i përcaktuar në Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar do të konsolidojë të gjitha Këstet e Principalit dhe interesin që janë të detyrueshme në datën e dorëzimit të Deklaratës së Pranimit të Detyrimit Financiar, në përputhje me dispozitat e nenit 6.11.

8.3 CDP-ja do të regjistrojë në Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar çdo pagesë të principalit dhe interesit dhe, sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e përfshira në Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar, do t'ia kthejë Huamarrësit të njëjtin dokument, të nënshkruar sipas rregullave si dëshmi të marrjes.

Neni 9

Angazhimi i Huamarrësit

9.1. Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e detyrueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe të Deklaratës përkatëse të Pranimit të Detyrimit Financiar, është i pavarur, absolut, pa kushte dhe i parevokueshëm.

9.2. Huamarrësi do t'i përmbushë të gjitha kërkesat e CDP-së "njih klientin tënd", si dhe legjislacionin italian për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të rregullave të tjera në fuqi herë pas here në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit (duke përfshirë, për shembull, Direktivat Evropiane për Luftën kundër Pastrimit të Parave, dekretin legjislativ 231/2007 dhe Konventën e OECD-së (Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) për luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksione ndërkombëtare, të datës 17 dhjetor 1997).

9.3. Huamarrësi angazhohet që:

i. të përmbushë të gjitha kërkesat e CDP-së "njih klientin tënd", si dhe rregulloret në fuqi herë pas here për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit (duke përfshirë, për shembull, Direktivat Evropiane për Luftën kundër Pastrimit të Parave, dekretin legjislativ 231/2007 dhe Konventën e OECD-së (Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), të datës 17 dhjetor 1997). Në këtë drejtim, do t'i sigurojë CDP-së të gjitha dokumentet dhe informacionet shtesë të nevojshme ose të dobishme për përmbushjen e procedurave të CDP-së "njih klientin tënd" dhe përditësimin e tyre herë pas here, si dhe për qëllime monitorimi;

ii. të mos përdorë, investojë ose në asnjë rast të vërë në dispozicion, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të ardhurat nga huamarrja nga CDP-ja në përfitim të subjekteve të sanksionuara, në një vend të sanksionuar ose me mjete të tjera që përfshijnë shkeljen e sanksioneve ose zbatimin e masave kufizuese të bazuara në sanksione.

9.4. Huamarrësi angazhohet të përmbushë parimet e përfshira në Kodin Etik të CDP-së, Modelin CDP 231 dhe Politikën Antikorrupsion të Grupit CDP, si dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim që synon të bindë dhe/ose detyrojë në ndonjë mënyrë:

i. ndonjë person që mban pozicione përfaqësimi, drejtimi apo menaxhimi në CDP, apo në ndonjë njësi organizative me autonomi funksionale dhe financiare;

ii. ndonjë person që është nën drejtimin apo mbikëqyrjen e ndonjërit prej personave të përmendur në paragrafin (a) më sipër; ose

iii. ndonjë prej konsulentëve të jashtëm të CDP-së që të shkelë parimet e Kodit Etik të CDP-së, Modelin CDP 231 dhe/ose Politikës Antikorrupsion të Grupit CDP.

Neni 10

Deklaratat dhe garancitë

Huamarrësi do të deklarojë, kryesisht, sa më poshtë:

10.1. Se ka lexuar dhe konfirmon parimet e përfshira në Kodin Etik të CDP-së, modelin CDP 231 dhe Politikën Antikorrupsion të Grupit CDP.

10.2. Është në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret dhe rregullat e zbatueshme për luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit ndërkombëtar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në Direktivat Evropiane për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Rregulloret për Luftën kundër Pastrimit të Parave.

10.3. Se i ka dorëzuar CDP-së menjëherë të gjitha dokumentet e kërkuara për të përfunduar në mënyrën e duhur procedurat e brendshme të lidhura me Rregulloret mbi Pastrimin e Parave ("njih klientin tënd").

10.4. Se as Huamarrësi, as drejtuesit e tij, as pronarët përfitues:

i. nuk kanë shkelur ndonjë prej masave të përmendura në pikën (ii)(a) më poshtë, apo masa kufizuese tregtare, ose të kontrollit të eksportit ("Sanksionet");

ii. nuk janë në pronësi, nën kontroll, apo duke vepruar në emër të individëve, apo subjekteve, që:

a) janë objekt i masave për ngrirjen e pasurive ose burimeve ekonomike, ose ndonjë mase tjetër kufizuese nxjerrë nga Zyra e Kontrollit të Pasurive të Huaja dhe Departamenti i Thesarit të SHBA-së (OFAC), Departamenti i Shtetit të SHBA-së, apo ndonjë mase ekuivalente të Bashkimit Evropian, Republikës së Italisë ose Kombeve të Bashkuara ("Subjekte të Sanksionuara");

b) janë të vendosur, të ngulur apo banojnë në një shtet apo territor që është, apo qeveria e të cilit është, objekt i sanksioneve ndërkombëtare, të cilat i kufizojnë gjerësisht marrëdhënien me atë vend, territor apo qeveri ("Vend i Sanksionuar", përfshirë, por pa u kufizuar ,ndaj Iranit, Koresë së Veriut, Sirisë, Bjellorusisë, Rusisë, Krimesë, Donbasit apo Venezuelës).

Neni 11
Mjetet juridike

11.1. Mjetet e përgjithshme juridike

Në rast se: i. ndonjë nga angazhimet e ndërmarra nga Huamarrësi në bazë të nenit 9.3 nuk përmbushet; ose ii. ndonjë nga deklaratat e bëra nga Huamarrësi në bazë të nenit 10 rezulton të jetë e rreme, jo e plotë, e pasaktë apo jokorrekte, lidhur me faktet dhe rrethanat që gjendeshin në datën kur deklarata është bërë apo përsëritur; apo iii. gjatë vlefshmërisë së Marrëveshjes Financiare, edhe në vijim të ndonjë komunikimi të bërë nga Huamarrësi, sipas nenit 9, statusi i Huamarrësit ndryshon negativisht, në lidhje me rrethanat e nxjerra në momentin e lidhjes së Marrëveshjes Financiare, në atë mënyrë që të ndikojë ndjeshëm në aftësinë e tij – përfshirë edhe aspektin ekonomik apo financiar – për të përmbushur angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshja Financiare, CDP-ja ka të drejtën ta pezullojë disbursimin e mëtejshëm, të tërhiqet nga Marrëveshja Financiare dhe/ose ta ndërpresë atë.

11.2. Dëmshpërblimi

Palët përkatëse angazhohen ta dëmshpërblejnë, ta mbajnë të padëmtuar dhe ta mbrojnë CDP-në nga çdo kosto, shpenzim, humbje, përgjegjësi, barrë apo dëmtim i provuar, madje edhe që njihet, që i është shkaktuar CDP-së dhe që nuk do të kishte ndodhur nëse deklaratat e bëra nga CDP-ja do të kishin qenë të vërteta, të plota, të sakta dhe korrekte, dhe angazhimet e përshkruara më sipër do të ishin përmbushur në mënyrë rigoroze.

Neni 12
Rastet e Mospërmbushjes

Çdo rast apo situatë e mëposhtme përbën rast mospërmbushjeje sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare (në vijim referuar si **"Rasti i Mospërmbushjes"**):

12.1. Huamarrësi dështon të shlyejë ndonjë principal apo interes të Huas së Butë sipas kërkesave të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

12.2. Çdo dokument i parashikuar në këtë Marrëveshje Financiare apo në Marrëveshje, ose çdo deklaratë apo garanci e bërë apo e konfirmuar nga ndonjëra palë apo përfaqësues të tyre zyrtare në këtë Marrëveshje Financiare, apo në Marrëveshje, rezulton të jetë i/e pavërtetë, i/e paplotë ose e rreme.

12.3. Ndërmerret ndonjë veprim apo ndodh një rast që pengon ose mund të pengojë Huamarrësin ose zyrtarët e tij nga ushtrimi i biznesit ose operacioneve, apo një pjese të konsiderueshme të tij.

12.4. Ndodhia e ndonjë veprimi, ngjarjeje, rrethane, ose miratimi i ndonjë legjislacioni apo rregulloreje administrative që ndikon në zbatimin e Programit, siç është parashikuar në këtë Marrëveshje Financiare, apo në Marrëveshje.

12.5. Huamarrësi ose ndonjë autoritet qeveritar i lidhur me të konfiskon, shtetëzon, sekuestron apo e shpronëson tërësisht, apo ndonjë pjesë thelbësore të pronës, apo pasurive të tjera të subjektit, ose subjekteve që përfitojnë nga Programi, të cilët marrin pjesë në të, ose të kapitalit të tij/tyre aksionar, ose fiton shumicën e pronësisë së subjektit ose subjekteve që përfitojnë nga Programi.

12.6. Huamarrësi bëhet, komandohet ose kontrollohet nga apo vepron në emër të një subjekti ose personi që bëhet objekt i sanksioneve ekonomike, tregtare apo masave kufizuese të administruara nga Zyra e Kontrollit të Pasurive të Huaja të Departamentit të Thesarit të SHBA-së (OFAC), ose çdo mase ekuivalente të Bashkimit Evropian, Mbretërisë së Bashkuar apo Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë sanksionet e vendosura kundër shteteve, organizatave dhe individëve të caktuar, sipas Politikës së Jashtme të Përbashkët dhe Sigurisë së BE-së ("Subjekti i Sanksionuar").

12.7. Të ardhurat e Huas së Butë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë dhënë me hua, investuar, kontribuar apo vënë në dispozicion të, ose në përfitim të ndonjë "Subjekti të Sanksionuar".

12.8. Huamarrësi dështon të përmbushë ndonjë detyrim material sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe/ose Marrëveshjeje, dhe nëse dështimi mund të riparohet, ai nuk riparohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga njoftimi i CDP-së për atë shkelje.

12.9. Huamarrësi ka shkelur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke vepruar nëpërmjet ministrave të qeverisë, nëpunësve civilë, nëpunësve të autorizuar, ndonjë ligj apo rregullore të zbatueshme kundrejt ryshfetit, korrupsionit apo pastrimit të parave në ndonjë juridiksion të zbatueshëm, në lidhje me Programin dhe përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare.

12.10. Çdo investim dhe/ose pagesë e bërë apo e marrë nga Huamarrësi, sipas apo në lidhje me Marrëveshjen Financiare, është financuar me fonde me Origjinë të Paligjshme, dhe asnjë burim fondesh i përdorur në lidhje me këtë Marrëveshje Financiare ose Program, nuk ka Origjinë të Paligjshme. **"Origjinë e Paligjshme"** nënkupton çdo origjinë që është e paligjshme apo false, duke përfshirë pa kufizim, trafikimin e lëndëve narkotike, korrupsionin, veprimtari kriminale të organizuara, terrorizmin, pastrimin e parave apo mashtrimin.

Neni 13
Pasojat e Mospërmbushjes së Detyrimeve

Nëse ndodh dhe vazhdon një Rast Mospërmbushjeje, pas kalimit të afatit kohor të caktuar nga CDP-ja në njoftimin përkatës për të rregulluar situatën, kur është e zbatueshme, atëherë në bazë të udhëzimeve të Autoriteteve Kompetente Italiane, të cilat do të veprojnë sipas gjykimit të tyre, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, CDP-ja mund të deklarojë të gjithë ose një pjesë të principalit dhe interesit të akumuluar mbi Huan e Butë, së bashku me ndonjë shumë tjetër të akumuluar ose të detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe sipas Marrëveshjes, e cila më pas do të bëhet menjëherë e detyrueshme dhe e taksative (pavarësisht ndonjë dispozite kundërshtuese në këtë Marrëveshje Financiare apo në Marrëveshje), pa njoftim shtesë, kërkesë apo kundërshtim të mëtejshëm të çfarëdo lloji, të cilat përjashtohen shprehimisht nga Huamarrësi.

Neni 14
Mungesa e përgjegjësisë dhe katastrofa natyrore

14.1 Në rast të pengesave për zbatimin e Programit për shkaqe të katastrofës natyrore (të tilla si: lufta, përmbytjet, zjarri, ciklonet, tërmet, konflikte të punës dhe greva, veprime të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura transporti apo shkaqe të tjera), do të zbatohen dispozitat e përcaktuara në nenin 12 të Marrëveshjes. CDP-ja do të ndjekë udhëzimet e Autoriteteve Kompetente Italiane, në lidhje me veprimtaritë e Programit.

14.2 CDP-ja nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë vonesë (apo pasojë të lidhur me të) në kreditimin e llogarisë me shumën për t'u paguar nga CDP-ja në përputhje me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje Financiare, në rastet kur vonesat janë shkaktuar nga rrethana jashtë fuqisë së saj.

Neni 15

Pezullimi i Disbursimit

Gjatë periudhës së disbursimit të Huas së Butë, CDP-ja rezervon të drejtën për ta pezulluar Kërkesën për Disbursim sipas nenit 6, në rastin kur ndodh: i. ndonjë Rast Mospërmbushjeje; ii. një mospërmbushje ndaj CDP-së, sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe/ose sipas ndonjë Huaje tjetër të Butë të dhënë nga Qeveria e Republikës Italiane për Qeverinë, Bankën Qendrore apo Agjencitë Shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 8 të ligjit italian nr. 125, datë 11 gusht 2014, ndryshuar herë pas here; iii. nëse ndonjë shtet tjetër pezullon disbursimin e Huave të ngjashme për Qeverinë, Bankën Qendrore apo Agjencitë Shtetërore të Republikës së Shqipërisë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në arsyet e lidhura me besueshmërinë kredituese të Qeverisë, Bankës Qendrore apo Agjencisë përkatëse). CDP-ja do ta informojë në kohë Huamarrësin për këtë pezullim.

Neni 16
Interesi për vonesë

16.1 Nëse për çfarëdolloj arsyeje, CDP-ja nuk merr ndonjë shumë të detyrueshme brenda afatit të caktuar, Huamarrësi do të paguajë interes për vonesën mbi shumën e papaguar, që nga data e afatit të pagesës deri në datën kur kryhet realisht pagesa në funksion të CDP-së.

16.2 Ky interes për vonesë do të llogaritet duke aplikuar formulën e tatimit të thjeshtuar, duke përdorur normën fillestare të interesit të përcaktuar në nenin 2.1 për një periudhë prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh pas afatit fillestar të pagesës. Më pas, interesi për vonesë do të llogaritet duke aplikuar normën fillestare të interesit të përcaktuar në nenin 2.1, të rritur me 0.5% (zero pikë pesë për qind), deri në datën e kreditimit real në funksion të CDP-së. Kjo normë interesi e vonuar do të përditësohet periodikisht nga Autoritetet Kompetente Italiane.

Neni 17
Tatimet

17.1 Çdo tatim aktual ose vijues që mund të jetë i detyrueshëm në Shqipëri për çfarëdolloj arsyeje të lidhur me këtë Marrëveshje Financiare dhe me Deklaratën e Pranimit të Detyrimit Financiar, do të mbulohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

17.2 Çdo tatim i detyrueshëm në Itali, që lidhet me këtë Marrëveshje Financiare, nuk do të mbulohet nga Huamarrësi.

17.3 CDP-ja deklaron se do të përfitojë nga statusi tatimor i përcaktuar në nenin 5, pika 24 e dekretit ligjor italian nr. 269, datë 30 shtator 2003, ndryshuar herë pas here.

Neni 18
Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje Financiare do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 19
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

19.1 Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Financiare.

19.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe në çdo rast, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

19.3 Në rast se edhe përpjekja sipas nenit 19.2 dështon ose (nëse përpjekja është bërë) nuk arrin një rezultat pozitiv brenda 30 (tridhjetë) ditëve, të gjitha mosmarrëveshjet që burojnë nga ose në

lidhje me këtë Marrëveshje, do të zgjidhen përfundimisht nga një Gjykatë Arbitrazhi me tre arbitra, sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë:

- një i emëruar nga Qeveria Shqiptare;
- një i emëruar nga CDP-ja;
- gjyqtari i tretë do të emërohet bashkërisht nga gjyqtarë e lartpërmendur ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

19.4 Nëse Qeveria Shqiptare ose CDP-ja nuk e emëron gjyqtarin e vet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e palës tjetër, gjyqtari do të emërohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

19.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, i cili do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës Italiane, do të jetë i formës së prerë dhe i detyrueshëm, pa kushte për të dyja palët, pa mundësi apelimi.

19.6 Asnjë mosmarrëveshje apo konflikt, që mund të lindë ndërmjet palëve, nuk do ta pezullojë detyrimin e Huamarrësit për t'i paguar, në datat e dakordësuara të maturimit, të gjitha shumat e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe, në veçanti, të gjitha shumat që rezultojnë nga afatet e shlyerjes së përcaktuara në nenin 6 dhe nga Deklaratat përkatëse të Pranimit të Detyrimit Financiar.

Neni 20
Ndryshimet

Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje Financiare duhet të bëhet me shkrim ndërmjet CDP-së dhe Huamarrësit. Huamarrësi është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. Ndryshimet në këtë Marrëveshje Financiare, që lidhen vetëm me afatin e disbursimit të fondeve, nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë.

Neni 21
Privatësia

Huamarrësi konfirmon, në përputhje me dhe në funksion të dekretit legjislativ nr. 196, datë 30 qershor 2003 (Kodi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe të rregullores (BE) nr. 2016/679 ("Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave" ose "GDPR"), të dyja të ndryshuara dhe të integruara më pas, se të dhënat personale i janë dorëzuar CDP-së, në përputhje me këtë legjislacion dhe se të dhënat personale të lartpërmendura, të dhëna nga përfituesi, ose të siguruara drejtpërdrejt nga CDP-ja në kuadër të veprimtarisë së saj, përpunohen për qëllime të lidhura me dispozitat e kontratës, për të përmbushur detyrime ligjore ose për të respektuar dispozitat e autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e CDP-së, ose për t'ua dhënë, në rast mospagese nga Huamarrësi kontraktues i CDP-së, shoqërive për rikuperimin e kredive.

Neni 22
Njoftimet

Njoftimet që do të bëhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje Financiare, do të adresohen si më poshtë:

- Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 3, Tiranë, Shqipëri;
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al
- *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* – Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar; Via Goito nr. 4 – 00185 Roma, Itali, e-mail: fondorotativocs@cdp.it

Neni 23
Kopjet origjinale të Marrëveshjes Financiare

Kjo Marrëveshje Financiare është nënshkruar në dy kopje origjinale në gjuhën angleze. Një kopje origjinale do të mbahet nga secila palë.

Neni 24
Klauzola përfundimtare

Dispozitat e Marrëveshjes konsiderohen të ripërcaktuara shprehimisht sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe në rast mospërputhjeje, kjo Marrëveshje Financiare do të ketë përparësi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare.

/nënshkrimi/
Cassa Depositi e Prestiti
S.p.A. Z. Paolo Lombardo – Drejtor për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
Nënshkruar në Romë, më 12.11.2025

/nënshkrimi/
Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë
SH.S. Belinda Balluku – Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Nënshkruar në Romë, më 12.11.2025

SHTOJCA A

(Formulari i Kërkesës për Disbursim)

Nga: .... (Agjencia Zbatuese)

Për: *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*

Për dijeni: ..... (Huamarrësi)

Marrëveshja Financiare në vlerën ... euro (...) e nënshkruar nga ne në ..., në datën ..... dhe nga *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* në ...., në datën ... (në vijim referuar si **"Marrëveshja Financiare"**).

Termat e përcaktuar në Marrëveshjen Financiare mbajnë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Në bazë të nenit 6 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, kërkojmë që të merrni hua dhe si rrjedhojë ta kreditoni për ne brenda 30 (tridhjetë) ditëve në llogarinë nr. "[•]" dhe të hapur pranë Bankës ....., shumën prej ..... eurosh.

Ne e konfirmojmë se ju do të kreditoni shumën e kërkuar, me kusht që shuma përkatëse t'ju jetë vënë në dispozicion nga Autoritetet Kompetente Italiane.

Shuma e kredituar nga ju në llogari do të përdoret për zbatimin e Programit.

Sinqerisht,

Data .....

_____

(Nënshkrimi i Agjencisë Zbatuese)

SHTOJCA B

(Formulari i Deklaratës së Pranimit të Detyrimit Financiar)

HUAMARRËSI .....

Nr. .....

Vendi dhe data e lëshimit:

Marrëveshja Financiare

_____

Termat e përcaktuar në Marrëveshjen Financiare mbajnë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Në lidhje me Marrëveshjen ndërmjet [•] dhe Qeverisë së Republikës Italiane, të nënshkruar në ...., në datën ....., si dhe Marrëveshjen Financiare në vlerën prej eurosh [•], ndërmjet [•] Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (në vijim **"Huamarrësi"**) dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* (në vijim **"CDP"**), të nënshkruar në ...., në datën ..., (në vijim **"Marrëveshja Financiare"**), Huamarrësi konfirmon marrjen e shumave të mëposhtme nga CDP-ja:

..... euro, në datën .....

..... euro, në datën .....

....

Nisur nga kjo, Huamarrësi deklaron në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme se është debitor ndaj CDP-së, si menaxhuese, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Italiane, për Fondin Xhirues për Bashkëpunim dhe për Zhvillim, me zyrë të regjistruar në Romë (Itali), Via Goito 4, për shumën e principalit prej ..... (.....) eurosh që angazhohet ta shlyejë në ... (...) këste të barabarta të njëpasnjëshme [6-mujore (gjashtëmujore)], ku kësti i parë është i detyrueshëm në datën ..... dhe i fundit në datën ....., sipas afatit të shlyerjes të përcaktuar më poshtë.

Huamarrësi angazhohet ta paguajë interesin mbi Huan e Butë të disbursuar, të llogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Financiare, siç specifikohet në afatin e shlyerjes të përcaktuar më poshtë.

Huamarrësi do të shlyejë Kështet e Principalit (siç janë përcaktuar në Marrëveshjen Financiare) dhe do të paguajë interesin e parashikuar në këtë Deklaratë të Pranimit të Detyrimit Financiar, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datat e maturimit të dakordësuara, në funksion të CDP-së ose të personit/ve të autorizuar për t'i marrë, në fonde menjëherë të disponueshme, të çliruar nga çdo barrë, zbritje apo ndalesë në burim.

_____

(Inicialet e Huamarrësit)

SHTOJCA B

Nëse CDP-ja, për çfarëdolloj arsyeje, duke përfshirë arsyet përtej kontrollit të Huamarrësit, nuk merr ndonjë shumë që i takon brenda datës së maturimit, Huamarrësi do të paguajë përqindjen e vonesës për shumën e papaguar nga data e maturimit deri në datën e pagesës efektive, në funksion të CDP-së.

Kjo përqindje për vonesën do të llogaritet dhe përditësohet herë pas here nga Autoritetet Kompetente italiane, në përputhje me nenin 16 të Marrëveshjes Financiare.

CDP-ja do të shënojë herë pas here në këtë Deklaratë Pranimi të Detyrimit Financiar, çdo pagesë të marrë në lidhje me principalin dhe/ose interesin.

Kjo Deklaratë Pranimi të Detyrimit Financiar lëshohet në bazë të Huas së Butë në vlerë prej ..... (....) eurosh, të dhënë në përputhje me nenin 8 të ligjit italian nr. 125, datë 11 gusht 2014.

AFATI I SHLYERJES

Data e maturimit	**Kësti i principalit**	**Shënim [paguar/papaguar]**	**Interesat**	**Shënim [paguar/papaguar]**	**Totali**

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

F.ROT/AID 21/003/00

FINANCIAL AGREEMENT

Between

The Council of Ministers of the Republic of Albania represented by the Ministry of Finance

and

Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.

EURO 35,000,000.00

"Improvement of Electrical Power Transmission Network in Northern Albania following 2019 earthquake"

